



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002

Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	22.10.2024
NR/BR.	328/24
PËR/ZA TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës
NGA/OU/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim – Vendim për publikimin e listës së pronave të Komunës së Ferizajt për dhënie në shfrytëzim për vitin 2025

Bazuar në neni 13 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme si dhe nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr 09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme, neni 58 pika 1.h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe neni 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës të marrë:

Propozim-Vendim

Për:

- I. Publikimin e listës së pronave komunale për dhënie në shfrytëzim për vitin 2025.

II. Pronat e përshkruara në listë mund të ipen në shfrytëzim vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore dhe planifikimit në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe dokumenteve tjera të planifikimit.

Arsyetim

Komuna e Ferizajt është njëra ndër qendrat më të rëndësishme ekonomike, industriale e tregtare në Republikën e Kosovës. Ky fakt ka nxitur edhe shpërnguljen e banorëve të lokaliteteve të ndryshme të Rajonit të Ferizajt në territorin e komunës sonë. Zhvillimi i shpejt dhe i qëndrueshëm i Komunës së Ferizajt ka lindur nevojën e zgjerimit dhe shtrirjes së biznesit dhe planifikimeve shtetërore në fushën e ekonomisë dhe fushat të tjera me ç' rast edhe ekonomizimin e pronës publike me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik si interes i përgjithshëm publik.

Ne si qeveri lokale, kemi hartuar një plan masash në fushën ekonomike që do të nxisin zhvillimin e përgjithshëm e veçanërisht ekonomik në territorin që pushteti lokal administron, për të përballuar nevojat dhe kërkesat e trendit zhvillimor nga qytetarët e komunës sonë. Në harmoni me planifikimet tona, komuna e Ferizajt planifikon që në të ardhmen të jep në shfrytëzim pronën komunale me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik, rritjen e vlerës së pronës si dhe shtimin e vendeve të punës.

Nga ajo që u tha më lartë i propozoj Kuvendit të komunës që të aprovoj publikimin e kësaj liste të pronave komunale në mënyrë që pas plotësimit të kushteve ligjore dhe në varësi nga interesi publik të zhvillohen procedurat për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale.

Lista e pronave;